



2021

**Sfidat dhe Efektet
e Zbatimit të Ligjit
75/2019 “Për Rininë”**



**KONRAD
ADENAUER
STIFTUNG**

PARATHËNIE

Gjatë viteve të fundit, Fondacioni Konrad Adenauer (KAS) në Shqipëri ka qënë mbështetësi kryesor i Kongresit Rinor Kombëtar në analizën dhe monitorimin e zhvillimeve të politikave rinore qoftë në nivel lokal ashtu edhe atë qëndror.

Gjatë vitit 2018-2020, Kongresi Rinor Kombëtar dhe Fondacioni Konrad Adenauer kanë përmbyllur ciklin e parë 3 vjeçar të bashkëpunimit të programit të Kërkimit, Monitorimit dhe Vlerësimit në kuadër të të cilit janë zhvilluar Seritë e Rezolutës së Rinisë. Si rezultat i këtyre serive janë publikuar tre raporte analitike si: “Drejtë një Dialogu më Efektiv” (2018); “Përfaqësimi dhe Pjesëmarrja e të Rinjve në Zgjedhjet e 2019” (2019) dhe “Analiza e Politikave Rinore në Nivel Qëndror” (2020).

Si pasojë e zhvillimeve të dy viteve të fundit dhe kryesisht miratimit të Ligjit “Për Rininë” në vitin 2019, Kongresi Rinor Kombëtar ka vijuar punën në kuadër të programit të Kërkimit, Monitorimit dhe Vlerësimit me ciklin e ri të punimeve për vitin 2021-2023. Gjatë vitit 2021, KRK me suportin e Fondacionit Konrad Adenauer është anagazhuar në monitorimin e Ligjit të Rinisë, duke analizuar efektet dhe sfidat e zbatimit të tij.

Megjithatë reagimi i KRK dhe organizatave anëtare të Asamblesë së Përgjithshme, ka nisur që në vitin 2019, ku pas një turi të gjatë konsultimesh KRK ka dalë me një deklaratë publike me kërkesa dhe rekomandime ndaj politikëbërësve, por kjo kërkesë nuk u mor parasysh dhe miratua pa integruar komentet e organizatave të shoqërisë civile.

Në këtë kuadër, besimi tek implementimi, efektiviteti dhe zbatueshmëria e plotë e Ligjit “Për Rininë” është i ulët. Për këtë arsye KRK ka ndërmarrë këtë iniciativë për te identifikuar barrierat, problematikat dhe ngërçet që nuk kanë lejuar mirëfunksionimin e tij në terren dhe përmbushjen e gjitha detyrimeve ligjore nga ana e institucioneve përkatëse.

Autorë:

Dafina **Peci**, Rigels **Xhemollari**, Enxhi **Lipa**

© Ky publikim nuk mund të përdoret për arsye komerciale pa miratimin me shkrim të autorëve dhe Fondacionit Konrad Adenauer. Opinonet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të donatorit.

Publikuar më: 31 Tetor 2021

PËRMBAJTJE

Parathënie.....	2
Lista e Shkurtimeve.....	4
Lista e Figurave.....	5
1. Hyrje.....	6
2. Metodologjia.....	7
3. Ngritja e organeve të parashikuara nga ligji 75/2019 në nivel qendror.....	8
3.1 Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.....	8
3.2 Agjencia Kombëtare e Rinisë.....	10
3.3 Thirrja e parë e AKR për projekt propozime.....	10
3.4 Këshilli Kombëtar i Rinisë.....	11
3.5 Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore.....	12
4. Zbatimi i ligjit 75/2019 në nivel vendor.....	14
5. Perceptimi i OSHC-ve mbi implementimin e Ligjit të Rinisë.....	27
6. Gjetjet kryesore.....	28
7. Rekomandime.....	30
8. Anekse.....	31

LISTA E SHKURTIMEVE

AKR	Agjencia Kombëtare e Rinisë
KB	Këshilli Bashkiak
KKR	Këshilli Kombëtar i Rinisë
KVR	Këshilli Vendor Rinor
MASR	Minsitria Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MSHRF	Ministri e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët
OKPR	Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Informimi mbi ligjin 75/2019 “Për Rininë

Figura 2: Faza e procesit të implementimit të ligjit 75/2019 “Për Rininë”

Figura 3: Ngritja e Këshillave Vendor Rinor

Figura 4: Plani dhe Buxheti për Implementimin e Ligjit për Rininë

Figura 5: Buxheti Specifik në dispozicion të Rinisë


Figura 6: Struktura/Personi Përgjegjës për Rininë

Figura 7: Dokumenti Strategjik për Rininë

Figura 8: Databaze e Organizatave Rinore në Nivel Lokal

1. HYRJE

Më 11 nëntor 2019 në Kuvendin e Shqipërisë u miratua ligji 75/2019 “Për Rininë”. Ky ligj kaloi nëpërmjet një procesi 1-vjeçar konsultimi publik që nisi më 15 nëntor 2018. Ligji kaloi në parlament me shumë polemika dhe debat publik nga grupet e interesit dhe organizatat rinore të cilat pretendonin se



ligji i jep kompetencat e organizatave dhe grupimeve rinore Kryetarëve të Bashkive dhe më herët Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, centralizon lirinë e organizimit të të rinjve dhe kanalizon fondet për të rinjtë nëpërmjet institucioneve të cilat kanë nivel të ulët besueshmërie në shtet dhe tyre.

Pavarësisht debateve, në Dhjetor të vitit 2019 ligji hyri në fuqi dhe filloi të shtrijë efektet e tij tek të rinjtë dhe organizatat rinore. Ligji ka për

objekt kryesor mbrojtjen e të drejtave të të rinjve dhe garantimin e kushteve për aktivizim rinor në Shqipëri. Shqipëria aplikon për here të parë një ligj për rregullimin e veprimtarive rinore por nisur nga eksperiencat e mëparshme me ligje të tjera të fokusuara tek të rinjtë si “Ligji për Arsimin e Lartë” apo “Ligji për Vullnetarizmin”, sfida kryesore e këtij ligji është zbatimi i tij. Nga njëra anë pritet detajimi dhe nxjerrja e akteve nënligjore që e bëjnë ligjin të zbatueshëm dhe nga ana tjetër buxhetimi i tij për të prodhuar efektet e pritshme.

Kongresi Rinor Kombëtar në kuadër të objektivave të tij për mbrojtjen e të drejtave të të rinjve dhe rritjen e pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrje, nëpërmjet kësaj nisme do të angazhohet për të monitoruar efektet dhe impaktin e ligjit për rininë. Fokusi i KRK do të jetë në nxjerrjen dhe zbatimin në afat të akteve nënligjore të cilat e bëjnë të zbatueshëm ligjin, fondet e akorduara nga shteti në funksion të zbatimit të ligjit dhe transparencën e ngritjes së organeve të parashikuara nga ky ligj.

Gjetjet, rekomandimet dhe diskutimet që do të prodhojë kjo iniciativë do të shërbejnë për të përmirësuar nivelin e zbatueshmërisë së ligjit dhe nxitur përgjegjshmërinë e organeve ligjzbatuese në funksion të promovimit dhe mbrojtjes të së drejtave të të rinjve në Shqipëri.

2. METODOLOGJIA

Nga të gjitha metodat e kërkimit shkencor në shkencat sociale, metodologjia e këtij raporti bazohet në metodologjinë mikse, duke përfshirë të dhëna sasiore dhe cilësore. Gjenerimi i informacionit dhe të dhënave të përfshira në këtë raport është ndarë në tre faza kryesore: rishikim i literaturës dhe kërkimi paraprak, kërkesa për informacion, pyetësorë online dhe intervista gjysëm të strukturuar me institucionet në nivel lokal dhe kombëtar (Aneksi 1 & 2) dhe zhvillimi i dy fokus grupeve të dedikuara me organizatat rinore aktive në Tiranë dhe në rrethe.

Të dhënat e gjeneruara gjatë fazës së parë janë pasqyryar kryesisht gjatë kapitullit tre “Ngritja e Organeve në Nivel Qëndror” i cili është pasuruar gjithashtu me komentet e marra gjatë fokus grupeve dhe intervistave gjysëm të strukturuar, ndërkohë që kapitulli katër mbi “Zbatimin e Ligjit të Rinisë në Nivel Vendor” përmban të dhënat e marra nëpërmjetë dy formateve të posaçme (pyetësorit online dhe kërkesat për informacion) drejtuar 61 bashkive gjatë muajit Mars-Prill-Maj 2021.

Nga përgjigjet e marra rezulton se 40 bashki nga 61 u janë përgjigjur pyetësorit online ndërsa vetëm 20 prej tyre u janë përgjigjur kërkesës për informacion, e cila ishte një format më i zgjeruar se pyetësori. Në total nga të dyja format janë përgjigjur 43 bashki të vendit dhe të dhënat e paraqitura në këtë raport janë nxjerrë nga ky kampion.

Komentet kryesore të diskutimeve, shqetësimet dhe problematikat e identifikuar nga aktorët që janë përfshirë gjatë fokus grupeve, janë integruar në kapitullin pesë “Perceptimi i OSHC-ve mbi implementimin e Ligjit për Rininë”. Ky raport përmban të dhëna të përditësuara deri në Tetor 2021, duke ndjekur zhvillimet e fundit të institucioneve që parashikon Ligji për Rininë.

Burimet e informacionit dhe metodologjia e përdorur janë një vlerë e shtuar e këtij raporti pasi jep një pasqyrë të detajuar mbi implementimin e ligjit të Rinisë duke u bazuar një kampion gjithëpërfshirës dhe përgjithësues.

Ne synojmë që ky raport, jo vetëm të shërbejë për informimin e të rinjve, institucioneve apo organizatave që punojnë në sektorin rinor por të jetë një baze referuese të dhënash edhe për organet ligj zbatuese me qëllim marrjen e masave që sigurojnë mirëimplementimin, transparencën dhe mirëfunksionimin e Ligjit të Rinisë.

3. NGRITJA E ORGANEVE TË PARASHIKUARA NGA LIGJI 75/2019 NË NIVEL QENDROR

Në nivel qendror, shpesh herë çështjet e rinisë janë trajtuar si kompetencë e ministrive të ndryshme duke i ndërlidhur ato me çështje të tjera sociale apo me çështjet e edukimit, sportit, kulturës. Deri në Shtator 2021, çështjet rinore në Shqipëri janë trajtuar nën kompetencën e ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Në Shtator 2021 me vendim të Këshillit të Ministrave, organi përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë mbrojtjen e të drejtave të të rinjve, garantimin e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën sociale dhe koordinimin e çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen, përkujdesjen, shëndetin, mirërritjen dhe miredukimin e fëmijëve është Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët (MSHRF).

3.1 MINISTI I SHTESTIT PËR RININË DHE FËMIJËT

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët harton, zhvillon dhe monitoron politikën për:

- a) mbrojtjen e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse;
- b) krijimin e kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve;
- c) përcaktimin e funksioneve dhe kompetencave të institucioneve në nivel qendror dhe vendor për çështjet e rinisë;
- ç) bashkëpunimin me organizatat që ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë;
- d) të rinjtë shqiptarë në diasporë, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për diasporën;
- dh) programet e shkëmbimit rinor ndërkombëtar.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, harton, zhvillon dhe monitoron politikën për:

- a) mbrojtjen e fëmijës, nëpërmjet plotësimit të kuadrit ligjor e institucional, në zbatim të Kushtetutës, të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, të akteve ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë, si dhe të legjisllacionit në fuqi;

b) parashikimin e parimeve bazë ku mbështeten politikat kombëtare për të drejtat e fëmijës, mekanizmat efikasë, si dhe autoritetet përgjegjëse në nivel qendror e vendor dhe kompetencat e tyre në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës;

c) sigurimin e mirëqenies dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijës, duke promovuar e mundësuar zhvillimin e tyre në shoqëri, ndihmën dhe përkujdesjen efektive për fëmijën;

ç) marrjen e masave për t'i siguruar fëmijës ushtrimin e të drejtave, në përputhje me zhvillimin e personalitetit, bazuar në interesin më të lartë të tij;

d) marrjen e masave për të siguruar jetesën dhe zhvillimin e fëmijës;

dh) sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës;

e) parashikimin e mekanizmave efektivë dhe funksionimin e institucioneve të ngarkuara me marrjen e masave konkrete për promovimin, respektimin e mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe për ngritjen e një sistemi të integruar e funksional të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit e neglizhimit.

Nga ana tjetër, në kuadër të "Ligjit për Rininë" janë parashikuar të ngrihen edhe 3 autoritete të tjera në nivel kombëtar të cilat do të kenë rol në sigurimin e zbatueshmërisë së ligjit.

Detyrat kryesore të tyre janë:

- të hartojnë politika sektoriale, aktet ligjore e nënligjore të nevojshme për të drejtat e të rinjve, si dhe të kontribuojnë në hartimin e politikave dhe programeve ndërsektoriale, duke siguruar edhe marrjen e mendimit të të rinjve;
- të parashikojnë në planet vjetore apo shumëvjeçare buxhetore fondet e nevojshme për përmbushjen progresive të të drejtave të të rinjve;
- të bashkëpunojnë me institucionet përkatëse për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të të rinjve.

3.2 Agjencia Kombëtare e Rinisë



Agjencia Kombëtare e Rinisë u krijua në 2 shtator 2020 me Vendim të Këshillit të Ministrave duke zvendësuar Shërbimin Kombëtar të Rinisë si strukturë qendrore përgjegjëse për rininë.¹ Misioni i Agjencisë Kombëtare të Rinisë është garantimi i mbrojtjes dhe i promovimit të të drejtave të të rinjve, nëpërmjet mbështetjes për edukim joformal, ndërveprimet e aktivizimit të rinisë dhe financimit të veprimtarive rinore, në zbatim të politikave shtetërore në fushën e rinisë.

AKR për herë të parë sjell instrumentin e financimit të organizatave rinore dhe për të rinjtë si kompetencë ekskluzive të saj. Aktualisht kjo agjenci deklaron se ka në dispozicion një shumë prej 54 milion lekësh në dispozicion të granteve për organizatat por ende nuk ka lancuar thirrjen e saj të parë.

Detyrat kryesore të AKR janë:

- Zbaton politikat dhe programet për të rinjtë
- Harton dhe menaxhon skemën e shpërndarjes së fondeve për projektet rinore
- Krijon, administron dhe mirëmban bazën e aksesueshme të të dhënave për rininë
- ofron shërbimin e ngritjes së kapaciteteve rinore pranë njësive të vetëqeverisjes vendore

3.3 Thirrja e parë e AKR për projekt propozime

Në datën 28 qershor 2021, Agjencia Kombëtare e Rinisë shpalli thirrjen për projekt propozime për organizatat rinore, ato për rininë dhe bashkitë e vendit.²

Rreth 3 muaj pas mbylljes së thirrjes për aplikime, në datën 3 nëntor AKR shpalli listën me 12 organizatat dhe 4 bashkitë përfituese.³ Në shpalljen e rezultateve nuk u publikuan shifrat e secilit përfitues dhe shuma totale e grantit në dispozicion. Sipas informacionit të marrë nga përfaqësues të institucionit në fokus grupet e organizuara nga Kongresi Rinor Kombëtar, në dispozicion të subjekteve konkurruese ishin 19.2 milion lekë për

¹ www.rinia.gov.al

² <http://rinia.gov.al/thirrja-e-pare-projekt-propozime-rinore-2/>

³ <http://rinia.gov.al/wp-content/uploads/2021/11/Projektet-Fituese.pdf>

organizatat për të rinjtë, 19.2 milion lekë për bashkitë dhe 9.6 milion për organizatat rinore. Me anë të kërkesës për informacion AKR vuri në dispozicion të KRK shumat e përfituara nga secili përfitues, të cilat variojnë nga 500.000 deri 8.000.000 lekë.

Ndërkohë para, gjatë ose pas procesit përzgjedhës nuk u publikua tabela e vlerësimit të pikëve, bordi i cili vendosi për projektet fituese dhe kriteret vlerësuese. Përfaqësuesit e organizatave rinore dhe për të rinjtë në fokus grupet e organizuara nga KRK u shprehën se procesi i thirrjes nuk ishte i mirëmenaxhuar dhe ishte jo transparent. Ndërkohë një pjesë e përfaqësuesve të organizatave u shprehën se thirrja ka qënë e komplikuar, burokratike dhe është hapur në një periudhë të papërshtatshme për organizatat (muaji Gusht).

Sipas përgjigjes nga AKR, Bordi përzgjedhës është ngritur me Urdhër të Minsitrit të Arsimit dhe jo nga vetë AKR, e cila sipas ligjit për Rininë është një institucion autonom. Gjithashtu problematik mbetet fakti që nuk ka pasur një modalitet të caktuar për krijimin e këtij bordi, duke pasur parasysh se ai përbëhet vetëm nga zyrtarë të lartë të qeverisë, disa prej të cilëve nuk rezultojn të kenë as eksperiencë mbi aktivitetin e organizatave rinore dhe për të rinjtë. Sa i përket procesit vlerësues, edhe nga përgjigja e marrë nga AKR nuk vërehet se ka pasur tabele vlerësuese, por komisioni i është referuar vetëm kriterëve të thirrjes në apriori.

3.4 Këshilli Kombëtar i Rinisë

Fitues për anëtarë të KKR-së si përfaqësues të Organizatave Rinore dhe/ose për të Rinjtë:	
1. Gentjan Hajdari	33 vota
2. Nensi Dragoti	22 vota
3. Eryjola Osmanaj	20 vota
4. Elias Mazloum	20 vota
5. Ana Gjoka	16 vota
6. Besart Mataj	14 vota
7. Klajdi Kaziu	11 vota
8. Klaudio Pulaha	9 vota

Fitues për anëtarë të KKR-së si përfaqësues të Këshillave Studentor:	
1. Enida Koni	550 vota
2. Enxhi Prodani	436 vota
3. Erid Rama	426 vota
4. Dajana Gërdani	353 vota

Këshilli Kombëtar i Rinisë është **organ këshillimor**, që funksionon pranë ministrit përgjegjës për rininë. KKR i propozon Minsitrit politikat, programet dhe buxhetin për rininë. Këshilli Kombëtar i Rinisë kryesohet nga ministri përgjegjës për rininë dhe ka në përbërje 14 deri në 16 anëtarë, ku të paktën gjysma e anëtarëve përfaqësojnë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë. Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Rinisë emërohen me urdhër të ministrit përgjegjës për rininë.

Më 29 Janar 2021 Agjencia Kombëtare e Rinisë shpalli thirrjen për aplikime për Këshillin Kombëtar të Rinisë ku ftonte organizatat të propozonin dhe votonin për përfaqësuesit potencialë për anëtarë të KKR.⁴

Më 24 Mars 2021 u publikua raporti përfundimtar mbi shpalljen e anëtarëve fitues të KKR, ku 8 anëtarë vinin nga votat e organizatave rinore, 4 si përfaqësues të Këshillave Studentore.

3.5 Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore



Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore është një organizatë që themelohet, organizohet dhe funksionon në zbatim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse dhe e ushtron veprimtarinë në përputhje me statutin e saj. Të drejtën për të themeluar Organizatën Kombëtare Përfaqësuese Rinore e kanë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë, të cilat pranojnë qëllimin, fushën e veprimtarisë dhe përcaktimet e tjera të kësaj organizate, të rregulluara në statutin e saj. Kriteret që duhet të përmbushë Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore, për t'u njohur si e fillë nga institucioni përgjegjës për rininë, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Më datën 12 Maj 2021 Këshilli i Ministrave nxorri VKM nr. 274 'Për përcaktimin e kriterëve që duhet të përmbushë organizata kombëtare përfaqësuese rinore', ku kryesisht theksohet se OKPR-ja) themelohet nga organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë, në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë duke përmbushur kriteret e mëposhtme:⁵

-Të jetë e themeluar dhe e regjistruar në gjykatën kompetente në formën e një shoqate meanëtarësi nga organizata rinore dhe/ose për të rinjtë, në përputhje me legjislacionin në fuqi përorganizatat jofitimprurëse;

-Të ketë statut të miratuar nga gjykata kompetente;

-Të ketë një anëtarësi prej jo më pak se 60 (gjashtëdhjetë) organizatash rinore dhe/ose për të rinjtë, të cilat duhet:

⁴ <http://rinia.gov.al/thirrja-per-krijimin-e-keshillit-kombetar-rinor/>

⁵ <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2021/05/12/274>

- ✓ të kenë si objekt të veprimtarisë së tyre të parashikuar në statutin e organizatës aktivitetet dhe veprimtari rinore, të kenë shlyer detyrimet tatimore në përputhje me legjislacionin në fuqi,
- ✓ të kenë përvojë në aktivitetet dhe veprimtari të rinore;
- ✓ të mos jenë në proces falimentimi dhe/ose likuidimi;
- ✓ të mos jenë të dënuar, organizata dhe përfaqësuesi i saj ligjor, me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- ✓ të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në 12 (dymbëdhjetë) qarqet e Republikës së Shqipërisë, sipas ndarjes territoriale;
- ✓ të kenë diversitet në fushat e veprimtarisë rinore ose për të rinjtë në të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

Në datën 31 Maj 2021 Agjencia Kombëtare e Rinisë shpalli thirrjen për aplikime për Organizatën Kombëtare Përfaqësuese Rinore, ku kriteret ishin ato që parashikonte VKM-ja e dt 12 Maj.⁶ Prej muajit Maj deri në muajin Dhjetor, pra gati për 7 muaj nuk pati asnjë aplikim të vetëm në këtë thirrje dhe aktualisht kjo organizatë mbeti e pa formuar. Sipas opinioneve të përfaqësuesve të organizatave të pyetur nga KRK, thirrja pati problematikë të parë mungesën e një afati për aplikuesit dhe së dyti paqartësinë dhe ndërveprimin që kjo organizatë do të ketë me organet e tjera të ngritura në kuadër të zbatimit të ligjit për rininë, si Këshilli Kombëtar Rinor apo vetë AKR-ja.

⁶ <http://rinia.gov.al/thirrja-per-krijimin-e-organizates-kombetare-perfaqesuese-rinore/>

4. ZBATIMI I LIGJIT 75/2019 NË NIVEL VENDOR

Ligji 75/2019 përveç funksioneve që i ngarkon organeve në nivel qendror, parashikon edhe disa funksione të rëndësishme për organet e vetë qeverisjes vendore. Sipas ligjit “Për Rininë” bashkitë duhet të hartojnë dhe zbatojnë politikat vendore në fushën e rinisë dhe janë përgjegjëse për:


- a) pasqyrimin dhe respektimin e të drejtave të të rinjve, duke përcaktuar objektivat dhe prioritetet, si dhe të garantojnë zbatimin e tyre;
- b) krijimin e këshillit vendor të rinisë;
- c) organizimin dhe koordinimin e veprimtarive që synojnë arritjen e objektivave vendore në fushën e mbrojtjes dhe të fuqizimit të të rinjve;
- ç) organizimin dhe ofrimin e veprimtarive për të mbështetur mirëqenien dhe zhvillimin e të rinjve;
- d) nxitjen e vullnetarizmit të të rinjve dhe edukimin joformal të tyre;
- dh) financimin e krijimit dhe të zhvillimit të infrastrukturës rinore dhe të hapësirave rinore të sigurta;
- e) krijimin e strukturave administrative për çështjet e rinisë;
- ë) parashikimin, në buxhetet e tyre, të fondeve për realizimin e të drejtave të të rinjve

Duke qenë se Ligji “Për Rininë ” është miratuar që në vitin 2019, Kongresi Rinor Kombëtar vendosi të vëzhgojë situatën aktuale të implementimit të këtij ligji dhe detyrimeve që ai parashikon për strukturat e qeverisjes vendore. Për këtë arsye kemi përcaktuar indikatorët kryesorë të monitorimit.

Indikatorët e monitorimit janë:

- Informimi mbi ligjin 75/2019 “Për Rininë
- Faza e procesit të implementimit të ligjit 75/2019 “Për Rininë”
- Ngritja e Këshillave Rinorë Vendorë
- Plani dhe Buxheti për implementimin e ligjit “Për Rininë”
- Ekzistenca e një personi përgjegjës apo një specialisti për çështjet rinore
- Ekzistenca e një dokumenti strategjik apo plani veprimi për rininë
- Ekzistenca e një databaze të organizatave lokale
- Qasja e bashkisë ndaj të rinjve: programet dhe iniciativat
- Roli i organizatave të shoqërisë civile në nivel lokal


A. A keni dëgjuar për "Ligjin për Rininë?"



Nga rezultatet e nxjerra nga përpunimi i të dhënave duket se të gjitha bashkitë që janë përgjigjur janë në dijeni të ligjit “Për Rininë ” dhe dispozitave që ai parashikon për institucionet vendore në vend.

Figura 1: Informimi mbi ligjin 75/2019 “Për Rininë

B. A ka filluar implementimi i "Ligjit për Rininë" në bashkinë tuaj?




Aspekti kryesor që Kongresi Rinor Kombëtar ka synuar të monitorojë është fillimi i implementimit të ligjit “Për Rininë” në bashkitë e vendit. Siç pasqyrohet edhe në Figurën 2, vetëm 72.1% e bashkive që i janë përgjigjur pyetësorit e kanë filluar këtë proces ndërkohë që 27.9% e tyre i janë përgjigjur negativisht kësaj pyetje.

Figura 2: Faza e procesit të implementimit të ligjit 75/2019 “Për Rininë”

Bashkitë të cilat shprehen se ky proces nuk ka filluar ende janë bashkia: Lushnje, Mirditë, Kuçovë, Mallakastër, Malësi e Madhe, Klos, Devoll, Dibër, Dropull, Memaliaj, Divjakë dhe Maliq.

Bashkitë të cilat kanë avancuar me implementimin e “Ligjit për Rininë” janë bashkia: Elbasan, Berat, Pogradec, Cërrik, Bulqizë, Peqin, Shijak, Librazhd, Tiranë, Fushë Arrëz, Kurbin, Kolonjë, Selenicë, Gramsh, Delvinë, Kamëz, Patos, Përmet, Prrenjas, Libohovë, Has, Krujë, Rogozhinë, Durrës, Skrapar, Korçë, Lezhë, Kukës, Mat, Kavajë, Puke dhe Has.


C. A ka filluar ngritja e Këshillave Rinor Vendorë pranë bashkisë suaj?



Neni 7, pika 1/b, i Ligjit për Rininë, parashikon krijimin e Këshillave Vendorë të Rinisë në 61 bashkitë e vendit. Nga monitorimi që kemi zhvilluar rezulton se 46.5% e bashkive nuk e kanë filluar ende ngritjen e kësaj strukture ndërsa 53.5% e tyre janë aktualisht duke e kryer këtë proces.

Figura 3: Ngritja e Këshillave Vendor Rinor

D. A ka bashkia juaj nje plan dhe buxhet për përmbushjen e direktivave që parashikon "Ligji për Rininë"?



Implementimi i mirë i një ligji krahas dispozitave ligjore dhe një plani të detajuar pune dhe aktiviteteve, ka nevojë për një sërë burimesh duke renditur si më të rëndësishmet burimet financiare dhe njerëzore. Por a i kanë bashkitë tona burimet e duhura për implementimin e plotë të këtij ligji?


Figura 4: Plani dhe Buxheti për Implementimin e Ligjit për Rininë

Nga të dhënat e monitorimit rezulton se 74.4% e bashkive nuk kanë një buxhet të dedikuar për rininë e për rrjedhojë nuk kanë një buxhet për të përmbushur detyrimet ligjore që u imponon ligji për kryerjen e aktivitetëve rinore apo mbështetjen e nismave nga të rinjtë apo organizata rinore.

Bashkitë që rezultojnë se kanë një buxhet të dedikuar për rininë janë bashkia: Bulqizë, Tiranë, Kavajë, Kolonjë, Korçë, Krujë, Lezhë, Libohovë, Përmet, Pogradec, Prenjas, Rogozhinë dhe Shijak.

Megjithatë shumë prej këtyre bashkive e kanë përfshirë buxhetin për rininë tek aktivitete të tjera që ato zhvillojnë si aktivitete me karakter edukues, sportiv, ekonomik, etj.

Bashkitë të cilat kanë mundësuar një informacion më të detajuar në lidhje me buxhetin për rininë janë si më poshtë:




- Bashkia Bulqizë- 303.000 Lekë
- Bashkia Kavajë- 100.000 Lekë
- Bashkia Kolonjë- 200.000 Lekë
- Bashkia Lezhë- 500.000 Lekë
- Bashkia Përmet- 300.000 Lekë
- Bashkia Shijak- 500.000 Lekë
- Bashkia Libohovë-500.000 Lekë

Figura 5: Buxheti Specifik në dispozicion të Rinisë

Bashkia Tiranë është e vetmja bashki e cila ka buxhetin më të madh për rininë në nivel lokal. Buxheti total vjetor i Drejtorisë së Rinisë në Bashkinë Tiranë është 20.000.000 Lekë të reja.

E. A ka bashkia juaj një strukturë apo person të dedikuar për rininë?



Neni 8, pika 1 parashikon ngritjen e institucionit përgjegjës për rininë, që është person juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për rininë, që financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme dhe ushtron veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Figura 6: Struktura/Personi Përgjegjës për Rininë

Bazuar në “Ligjin për Rininë”, ky institucion duhet të kryejë detyrat e mëposhtme:

- a) zbaton politikat dhe programet për të rinjtë;
- b) organizon, administron, financon, koordinon dhe monitoron e mbikëqyr programet dhe projektet rinore;
- c) bashkëpunon me organizma, institucione, donatorë dhe subjekte të tjera, vendase e të huaja, për prezantimin dhe zbatimin e politikave, programeve dhe veprimtarive rinore;
- d) mbështet ngritjen e kapaciteteve të njësive dhe strukturave në nivel qendror dhe vendor
- e) krijon dhe mirëmban bazën e aksesueshme të të dhënave për rininë;
- f) siguron financime nëpërmjet aplikimit në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat transferohen mbi bazë vjetore në rastet kur miratohet një projekt shumëvjeçar;
- g) mbledh, administron dhe analizon të dhënat mbi situatën e të rinjve në bashkëpunim me institucionet e tjera dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- h) raporton në mënyrë periodike pranë ministrisë përgjegjëse për rininë për situatën e të rinjve dhe zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ky ligj;
- i) mbikëqyr veprimtarinë rinore dhe të punës me të rinjtë nga organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë, që përfitojnë mbështetje sipas parashikimeve të këtij ligji

Megjithatë vetëm 74.5% e bashkive që u janë përgjigjur pyetësorit rezultojnë të kenë një person të dedikuar për rininë. Pavarësisht këtij fakti, duket se ka një keqkuptim në konceptimin e personit të dedikuar, pasi shumë nga bashkitë në mungesë të kapaciteteve financiare dhe njerëzore ja kanë bashkëngjitur kompetencat që parashikon Ligji i Rinisë, një specialisti ekzistues. Gjithashtu shume prej tyre shprehen se nuk disponojnë një njësi të veçantë për rininë por e kanë integruar këtë

komponent kryesisht në drejtoritë apo sektorët që lidhen me edukimin, sportin, artin, kulturën, turizmin dhe zhvillimin e qëndrueshëm. 25.5% e bashkive në të cilat personi përgjegjës për rininë mungon janë: bashkia Bulqizë, Devoll, Dropull, Librazhd, Malesi e Madhe, Maliq, Mallakaster, Mirditë, Patos, Kurbin dhe bashkia Pukë.

F. A ka bashkia juaj një dokument strategjik apo plan veprimi për rininë?


Një tjetër komponent monitorimit i këtij raporti është edhe ekzistenca e një dokumenti strategjik apo plani veprimi për rininë në nivel lokal. Siç paraqitet edhe në grafik, 69.7% e bashkive që i janë përgjigjur pyetësorit nuk e disponojnë një dokument të tillë, ndërkohë që vetëm 30.3% e tyre shpehen se në bashkitë e tyre ky dokument ekziston.



Figura 7: Dokumenti Strategjik për Rininë

Bashkitë në të cilat ky dokument mungon janë: bashkia Berat, Bulqizë, Delvin, Devoll, Dibër, Dropull, Gramsh, Has, Kamëz, Klos, Kolonjë, Korçë, Krujë, Kuçovë, Libohovë, Librazhd, Lushnje, Maliq, Mallakastër, Mat, Memaliaj, Mirditë, Patos, Peqin, Rrogozhinë, Selenicë, Skrapar dhe Malësi e Madhe.

G. A ka bashkia juaj një databazë të organizatave rinore që operojnë në bashkinë tuaj?



Përveç buxhetit dhe planit strategjik, ekzistenca e një databaze të mirëfilltë për institucionet e pushtet vendor jo vetëm mundëson identifikimin e aktorëve lokal që kanë në fokus rininë por është edhe një aset për institucionin në aspekt menaxhimi, organizimi dhe ndërveprimi me aktorë të interesuar.

Figura 8: Databaze e Organizatave Rinore në Nivel Lokal

Për këtë çështje ne kemi monitoruar nëse bashkitë e vëndit e disponojnë një databazë të tillë në nivel lokal. Nga te dhënat rezulton se 55.8% e tyre nuk e disponojnë një databazë të tillë, ndërkohe që 44.2% shprehen se e disponojnë një të tillë.

H. Cila është qasja që ka bashkia juaj ndaj të rinjve? Programet dhe iniciativat aktuale?



Qasja që kanë institucionet ndaj rinisë është veçantërisht e rëndësishme jo vetëm për përfshirjen dhe angazhimin e tyre në mënyrë aktive në proceset e vendimarrjes por edhe për bashkëpunimin midis aktorëve të ndryshëm që operojnë në nivel lokal siç janë kryesisht bizneset dhe organizata të ndryshme të shoqërisë civile.

Nga përgjigjet e marra, rezulton se të gjitha bashkitë e vendit kanë një qasje të hapur, pozitive dhe konstruktive kur bëhët fjalë për rininë dhe iniciativa që mundet të angazhojnë ata, sidomos në nisma që kanë të bëjnë me përfshirjen e tyre në vendimarrje, jetën social-kulturore të vendit si dhe zhvillimin dhe fuqizimin ekonomik të të rinjve.

Disa bashki, siç janë Bashkia Dropull, Has, Klos, Maliq, Mallakastër dhe Selenicë shprehen se përtej vullnetit dhe dëshirës pozitive të tyre, mungesa e kapaciteteve njerëzore dhe financiare nuk u mundëson terrenin e përshtatshëm për të krijuar programe të dedikuara për të rinjtë dhe për pasojë nuk kanë ndonjë iniciativë konkrete në këtë aspekt.

Megjithëatë, bashki të tjera duket se janë përpjekur të krijojnë mundësi dhe hapsira për të rinjtë e qyteteve të tyre kryesisht në sajë të bashkëpunimeve me organizata të shoqërisë civile të cilët punojnë me fuqizimin e të rinjve dhe përfshirjes së tyre në jetën kulturore, artistike, sociale dhe sportive të komuniteteve ku ato jetojnë. Pavarësisht kësaj, ata theksojnë faktin se ky bashkëpunim duhet të vazhdojë në mënyrë më sistematike dhe të qëndrueshme.

Më poshtë është një pasqyrë me e zgjeruar e prioriteteve të bashkive që i janë përgjigjur pyetësorit dhe kërkesës për informacion që janë përdorur për gjenerimin e të dhënave:

- **Bashkia Berat** thekson se rinia është një ndër fushat e saj prioritare dhe fokusi i bashkisë në vijim do të jetë tek përmirësimi i infrastrukturës rinore, kryesisht në krijimin e një hapsire të dedikuar për ta, në formën e një qendre rinore si dhe ngritja e kapaciteteve të të rinjve dhe stafit që merret kryesisht me çështjet e emergjencave, nevojave të të rinjve dhe nxitjen e kauzave të caktuara nga ana e tyre.

- **Bashkia Cërrik** është në proces planifikimi të programeve dhe aktiviteteve për të rinjtë si aktivitete me karakter informues dhe vlerësues të nevojave të tyre.
- **Bashkia Delvinë** ka planifikuar disa aktivitete në bashkëpunim me Qendrën Kulturore dhe Qendrën Kulturore të fëmijëve
- **Bashkia Elbasan** thekson se rinia është një target grup shumë i rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të qytetit. Aktualisht Sektori i Rinisë në Bashkisë Elbasan është duke implementuar dy iniciativa me focus të rinjtë:

1- Nisma "Dixhitalizo një nxënës": ku të rinjtë e Këshillit Rinor në bashkëpunim me Sektorin e Edukimit Rinor dhe bizneset lokale po dhurojnë tableta për nxënësit në pamundësi të ndjekjes së mësimi online

2- Takime Informuese: Në bashkëpunim me institucionet arsimore 9-vjecare dhe të mesme për zhvillimin e takimeve edukative me nxënësit mbi tematikat dhe problematikat aktuale, me fokus informimin mbi dialogun e strukturuar, integrimin dhe reformimin e të rinjve si qytetarë të gatshëm, të aftë dhe të përgjegjshëm.

- **Bashkia Kamëz** shpreh se ka një qasje pozitive dhe mbështet iniciativat nga të rinjtë. Në bashkëpunim me CARITAS janë implementuar dhe vazhdon implementimi i programit për kryerejen e intershipeve 3-6 mujore pranë bizneseve lokale nga të rinjtë, janë mbështetur të rinjtë për hapjen e bizneseve të reja (start-up), si dhe programi i kurseve profesionale të paguara për të rinjtë. Gjithashtu, janë implementuar një sërë trajnimesh të ndryshme në tematika si: e folura në publik, njohja me legjislacionin etj. Për më tepër IDM ka implementuar projektin: "Shkolla Qëndër Komunitare". Ndërkohë USAID dhe IDEA kanë zhvilluar trajnime si edhe mbështetje për gratë dhe të rinjtë që duan të hapin ose zgjerojnë biznese.
- **Bashkia Kolonjë** thekson se ka një fokus të veçantë për të rinjtë e qytetit e sidomos për bizneset e reja. Një politikë aktuale e bashkisë Kolonjë në lidhje me bizneset e reja është mbulimi shpenzimeve të sigurimeve shoqërore me qëllim lehtësimin e barrës financiare të tyre.

- **Bashkia Korçë** si një nga bashkitë më të mëdha të zonës Juglindore të Shqipërisë ka një program më të gjërë dhe më të detajuar për të rinjtë. Disa nga iniciativat që kjo bashki ka implementuar janë:

1-Programi Kombëtar i Praktikave të Punës në Administratën Shtetërore, e cila ofron praktika profesionale me stimuj financiarë e cila implementohet nga Ministria e Arsimit, sportit dhe Rinisë Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë dhe zbatuar nga Bashkia e Korçës. Studentë të cilët kanë përfunduar arsimin e lartë në 2 vitet e fundit, janë angazhuar në drejtori të ndryshme në Bashki sipas profilit të studimit për të kryer praktika profesionale për një periudhë kohore prej 3-6 muajsh.

2-Ofrimi i Praktikave Mësimore për studentët, që vazhdojnë studimet në Universitetin "Fan.S. Noli" Korçë dhe angazhimi i tyre vullnetar në aktivitete të zhvilluara nga Bashkia Korçë.

3-Zbatimi i projektit "Bursa per gjimnazistet", përfitues të të cilit janë gjithë nxënësit gjimnazistë, që kanë përfunduar klasën e XI dhe të XII me të gjitha notat dhjeta. Projekti vlerëson me certifikata vlerësimi nxënësit përfitues, duke i shpërblyer ata me një bursë mujore për një vit të plotë shkollor.

4-Aktivitete sportive dhe argetuese për të rinjtë: Projektet: "Triathlon midis shkollave të mesme", "Tennis për të gjithë" etj.

5-"Korça Digital Weekend: aktivitet i realizuar për herë të parë në Korçë në datën 25 Janar 2020, nga Bashkia Korçë në bashkëpunim me qendrën laboratorike ICTSlab, Vigan Group, ABSA dhe Universitetin e Korçës "Fan S. Noli", për të promovuar vlerat dhe mundësitë që ofrojnë aftësitë dixhitale dhe ekonomia dixhitale për të rinjtë e Korçës dhe Shqipërisë.

- **Bashkia Krujë** është bazuar në një qasje ndaj të rinjve që titullohet "Bashkia e Hapur" duke e kthyer bashkinë në një institucion miqësor me ta dhe të hapur ndaj qytetarëve. Në kuadër të kësaj qasje, bashkia aktualisht zbaton programin e intershipeve apo praktikave profesionale në drejtori të ndryshme të saj. Një tjetër iniciativë është ofrimi pa pagesë i hapësirave dhe ambjentëve që bashkia ka në administrim me qëllim lehtësimin e aktiviteteve apo iniciativave rinore.

- **Bashkia Kuçovë** ka në strukturën e saj Qendrën Rinore, pjesë e institucionit Qendra Kulturore "Feniks". Qendra është mjaft aktive në zhvillimin e aktiviteteve rinore dhe përbehet kryesisht nga të rinj. Aktivitetet bazohen kryesisht tek: zhvillimi i politikave për përfshirjen e të rinjve në vendimarrje, evidentimi dhe monitorimi i problemeve të komunitetit dhe të të rinjve, krijimi i hapësirave për nxitjen dhe zhvillimin e iniciativave inovative nga të rinjtë e qytetit dhe takime informuese për ngritjen e kapaciteteve të tyre.
- **Bashkia Librazhd** i jep një vëmendje shumë të madhe të rinjve, duke i mbështetur nëpërmjet projekteve dhe aktivitete të ndryshme. Aktivitetet kryesore implementohen nga Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës me fokus të rinjtë dhe përmirësimi i infrastrukturës rinore si hapësira multifunktionale, qendra sportive etj. Qëllimi kryesorë që bashkia ka është ngritja e strukturave të dedikuara vetëm për të rinjtë, buxhetimi i tyre dhe implementimi i iniciativave për fuqizimin dhe aktivizimin e të rinjve.
- **Bashkia Mirditë** nuk ka një plan strategjik veprimi për rininë por në planin e përgjithshëm vendor të miratuar në vitin 2018, disa kapituj kanë në fokus ofrimin e shërbimeve publike cilësore, përmirësimin e kushteve në godinat e shkollave si dhe rikonstruksionin e mjediseve kulturore dhe rinore në territorin e bashkisë. Deri më tani janë rikonstruktuar totalisht shkollat në qendrat kryesore të bashkisë dhe janë mirëmbajtur sistematikisht shkollat e tjera. Pallati i Kulturës në qytetin e Rrëshenit, i cili është edhe shtëpia e Ansambllit të Këngeve dhe valleve Mirdita përbërë kryesisht nga të rinj, është në fazën e një rikonstruksioni të plotë.
- **Bashkia Patos** ka një qendrim pozitiv ndaj të rinjve. Për këtë arsye, ajo dedikon çdo vit një fond të posaçëm i cili është shpërndarë në programet e arsimit dhe kulturës, rinisë, sportit dhe programin e mjedisit. Nëpërmjet këtij fondi mbështeten të gjitha aktivitetet kulturore, sportive, mjedisore dhe sociale dedikuar të rinjve.
- **Bashkia Pogradec** ka një qasje tepër pozitive ndaj iniciativave dhe projekteve rinore. Ajo thekson se gjithëmonë është përpjekur të zgjidhë

probematikat që të rinjtë adresojnë në bashki duke vënë në dispozicion gjithë kapacitetet që disponon. Sektori i Rinisë është risi për Bashkinë Pogradec pasi më herët nuk ka pasur një strukturë të dedikuar për koordinimin e aktiviteteve dhe iniciativave rinore. Aktivitetet që janë realizuar deri më tani janë: njohja e të rinjve me trashëgimime kulturore, fuqizimi i tyre nëpërmjet një medie të shkruar, aktivitete në Ditën Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Rinisë, zhvillimi i një pyetëtori për Funksonimin e Qendrës Rinore, ngritja e Bibliotekës Rinore pranë ambienteve të rinisë dhe aktivitete për javën e Europës.

- **Bashkia Tiranë** është një nga bashkitë që ka avancuar më shumë përsa i përket mbështetjes së të rinjve duke ofruar jo vetëm një qasje strategjike ndaj tyre por edhe një buxhet të dedikuar për ta. Aktualisht bashkia Tiranë ka disa dokumenta strategjikë që përfshijnë rininë si: Strategjia për Rininë 2019-2023, Plani Lokal i veprimtimit për Rininë dhe Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tiranë . Aktualisht, Bashkia e Tiranës ka pjesën të strukturave të saj Këshillin e Rinisë të Këshillit Bashkiak, i cili përfaqëson interesat e të rinjve si dhe Bordin Rinor, i cili përbëhet nga përfaqësues të grupeve rinore. Bashkia Tiranë ka një Drejtori dhe Agjensi të dedikuar rinisë të cilat hartojnë dhe zbatojnë programe për përfshirjen, fuqizimin, informimin dhe promovimin e të rinjve.

Ndër programet më kryesore mund të përmendim:

- Biblioteka e Lagjeve si Qendra Multifunksional,
- Tirana Art Fest, Festivali Ndërkombëtar i Filmit/ Tirana 48 orë,
- Bordi Rinor,
- Public Speaking,
- Stand up Comedy,
- Festivali Letrar,
- Krijë poezinë tënde,
- Biblioteka Merr dhe Jep,
- Dhurimi i Librave,
- Festivali i Teatrit,
- Edukimi Mjedisor për të Rinjtë,
- Dita Kombëtare e Rinisë-8 Dhjetori;
- Earth Hour Tirana;
- Dita Ndërkombëtare e Rinisë-12 Gusht,

- Dita Ndërkombëtare e Vullnetarëve,
- Të rinjtë kundër korrupsionit
- Shqipëria e së Ardhmes-seri e Debateve Parlamentare me të Rinjtë

Gjithashtu ne bashkepunim me Drejtorinë e Nxitjes së Punësimit, Bashkia Tiranë implementon një sërë programesh që suportojnë grupe të caktuara të shoqërisë si student, gra dhe vajza dhe të rinjtë në zona rurale. Të tilla programe janë:

- Gjymnazistët për Tiranën Inovative "Tirana Cross Cut Youth Trail"
 - Projekti" Fuqizimi i Grave dhe Nxitja e Sipërmarrjes III"
 - Programi i Nxitjes së Punësimit në Ndihmë të Krijimit të Biznesit Social Rinor II
 - Projekti "Të Rinjtë Dhe Të Rejat Drejt Një Profesionit"
 - Projekti: "Fillo me një Ide Fito një Intership në Bashkinë e Tiranës"
- **Bashkia Shijak** shprehet se ka hartuar një platformë strategjike e cila ka si synim të nxisë aktivizimin e të rinjve në mënyrë që ata të luajnë një rol aktiv në demokratizimin dhe zhvillimin ekonomik vendor. Programi dhe iniciativat aktuale përfshijnë:
- 1- *Zhvillimi i aktiviteteve për parandalimin dhe reduktimin e problematikave të ndryshme madhore për të rinjtë me karakter psiko-social si bullizmi, dhuna në familje, barazia gjinore etj.*
 - 2- *Kryerja e aktiviteteve për promovimin e të rinjve, grave dhe vajzave në fushën e artit, sportit dhe kulturës.*
 - 3- *Rritja e informacionit mbi burimet natyrore dhe kulturore që ka territori i Bashkisë Shijak.*
 - 4- *Rritja e bashkëveprimit, komunikimit dhe ndërveprimit në fushën kulturore e të artit dhe me grupe të tjera rinore nga bashkitë fqinje si Durrësi, Kruja, Vora etj.*
 - 5- *Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit rinor në politkë dhe vendimmarrje.*
 - 6- *Nxitja e prodhimit të produkteve arizanale*

Bashkitë e tjera shprehen se përveç dëshirës dhe vullnetit të bashkisë për të zhvilluar aktivitetetë ndryshme për të rinjtë, mungesa e kapaciteteve bën që ato të kenë një numër të reduktuar aktivitetesh në bashkitë e tyre.

I. Si e vlerësoni rolin e organizatave të shoqërisë civile në bashkinë tuaj?

Përveç qasjes që bashkitë kanë ndaj të rinjve si grupmoshë, ne kemi analizuar edhe qëndrimin e tyre ndaj organizatave të shoqërisë civile në secilen nga bashkitë respektive. Si rezultat, ajo që vlen të theksohet është fakti së bashkitë kanë një qasje shume pozitive dhe vlerësim të lartë mbi punën e organizatave dhe fokusin e tyre në nivel lokal. Ajo që vihet re si tendencë është një vlerësim shumë i lartë sidomos nga bashki të vogla ose të lokalizuara në zona rurale ku për shkak të mungesës së kapaciteteve njerëzore dhe financiare, terrenit dhe numrit të popullsisë, organizatat e shoqërisë civile duket se janë aktorët e vetëm të cilët targetojnë të rinjtë në mënyrë të dedikuar nëpërmjet programeve dhe projekteve që ata implementojnë.

Konkretisht bashkitë Tiranë, Durrës, Kamëz, Bulqizë, Delvinë, Devoll, Divjakë, Gramsh, Has, Kavajë, Korçë, Krujë, Kuçovë, Lezhë, Librazhd, Patos, Peqin, Përmet, Pogradec dhe Shijak shprehen se bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile është shumë i rëndësishëm dhe ka rezultuar pozitiv sidomos në mbështetjen e grupeve që bashkia nuk i arrijnë dot, por edhe në krijimin e iniciativave që kërkojnë burime me të mëdha se sa bashkia mund të suportojë.

Megjithatë ka bashki në të cilat prania e organizatave të shoqërisë civile është e pakët dhe jo shumë evidente. Më konkretisht bashkia Berat, Cërrik, Dibër, Dropull, Elbasani, Klos, Kolonjë, Lushnja, Malësi e Madhe, Mallakastra, Kurbin, Fushë Arëz, Kukës, Memaliaj, Selenicë, Rrogozhinë, Pukë, Skrapar dhe Mirditë shprehen se në zonat e tyre nuk ka ose ka një numër të kufizuar të organizatave të shoqërisë civile të cilat kryejnë projekte vetëm në momentin që kanë një grant dhe në pjesën tjetër të kohës janë pasive.

Lidhur me këtë pikë, shumë nga bashkitë theksonë nevojën e mbështetjes nga oranzata të ndryshme dhe u bëjnë thirrje që të investojnë dhe të kthejnë vëmëndjen edhe nga të rinjtë që jetojnë në periferi dhe zona jo urbane me qëllim parandalimin e fenomenit të migrimit masiv të të rinjve në këto zona. Bashkitë shprehen të hapura dhe pozitive ndaj organizatave të ndryshme të cilat duan të punojnë me komunitetet lokale.

Një tjetër aktor i rëndësishëm i evidentuar nga bashkitë është edhe prania e grupeve jo formale sidomos në ato zona ku mungojnë organizatat e shoqërisë civile. Ato theksojnë se këto grupime janë të format e vetme në të cilat të rihtë mund të angazhohen në mënyre aktive dhe të përcjellin zërin dhe problematikat e tyre pranë insitucioneve dhe aktorëve përgjegjës. Megjithatë impakti i tyre mbetet i kufizuar pasi shumica e grupimeve funksionojnë në mënyrë vullnetare.

Në këtë sesion, bashkitë duket se bëjnë një thirrje jo vetëm ndaj organizatave por edhe kominutetit të donatorëve që të targetojnë këto zona ose të nxisin bashkëpunimin ndërsektorial dhe ndërinstitucional në këto zona.

Mungesa e infrastrukturës rinore, zhvillimi i ulët ekonomik, sipërmarrjet e pakta, mungesa e kapaciteteve të bashkive për të suportuar të rinjtë si dhe jeta e vakët social-kulturore dhe ekonomike në këto bashki dukët se janë faktorët kryesorë në emigrimin masiv të të rinjve. Në këtë aspekt, bashkitë e vendit i bëjnë thirrje organizatave të shoqërisë civile të zgjerojnë punën e tyre në këto zona.

5. Perceptimi i OSHC-ve mbi implementimin e Ligjit të Rinisë

Gjatë fokus grupeve që janë zhvilluar në kuadër të monitorimit të Ligjit të Rinisë janë angazhuar përfaqësues të organizatave rinore në kryeqytet dhe në rrethe. Diskutimet mbi këtë temë janë gjithënjë të shumta dhe vetë organizatat shprehen të shqetësuara për vijimin e implementimit të këtij ligji duke qenë se kapacitetet janë shumë të pakta sidomos në nivel vendor.

Disa nga problematikat kyçe që organizatat kanë identifikuar lidhur me implementimin e Ligjit të Rinisë deri më tani, janë:

Implementimi i ngadaltë: Shume prej organizatave shprehen se në bashkitë e tyre nuk ka zhvillime të dukshme të implementimit të ligjit për rininë. Sipas tyre, kjo vjen si mungesë e një analize e mirëfilltë të situatës aktuale përpara se ky ligj të hartohet apo miratohet. Ato shprehen se faza fillestare duhet të ishte ngritja e kapaciteteve të bashkive për implementimin e ligjit e më pas miratimi i tij.

Paqartësi mbi implementimin e ligjit: Disa nga përfaqësuesit e organizatave që punojnë në bashkitë e vogla, shprehen se midis punonjësve të bashkisë duket se ka një paqartësi se si do të implementohet ligji. Shkak është mungesa e kapaciteteve njerëzore dhe financiare pasi bashkitë e vogla nuk sigurojnë dot ndryshimin e strukturës së brendshme dhe krijimin e një pozicioni vakat për të paktën një specialist rinie. Ata shprehen se bashkitë nuk janë të qarta se si mund ti integrojnë detyrimet që u imponon ligji brenda strukturave ekzistuese.

Mungesa e transarencës nga organet ligjzbatuese: Shumë nga organizatat që punojnë në nivel lokal thonë se ka zhvillime mbi ngritjen e Këshillave Rinorë Vendorë megjithatë përzgjedhja e kandidatëve nuk ka qenë transparente dhe nuk është bërë publike në faqet zyrtare. Gjithatë kriteret dhe bordi përzgjedhjes nuk janë publikuar. I njëjti problem paraqitet nga ana e tyre edhe në thirrjen e parë për projekt propozime nga ana e AKR.

Poltizimi: Sipas organizatave rinore, risku me i madh që paraqitet gjatë implementimit të këtij ligji, është përzgjedhja e të rinjve që vijnë vetëm nga forumet rinore të partive politike dhe përdorimi i KVR për qëllime politike. Nëse kjo gjë ndodh, sipas organizatave, besimi ndaj të rinjve do të zbehej edhe më shumë dhe dinamikat në nivel lokal do të pësonin një përkeqësim të ndjeshëm.

6. GJETJET KRYESORE

- Në Shtator 2021 me vendim të Këshillit të Ministrave, organi përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë mbrojtjen e të drejtave të të rinjve, garantimin e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën sociale dhe koordinimin e çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen, përkujdesjen, shëndetin, mirërritjen dhe miredukimin e fëmijëve është Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët
- Gjatë vitit 2021 u konstituan dhe formalizuan KKR dhe AKR, dy institucione kryesore të ligjit për rininë dhe dolën udhëzimet për ngritjen e Organizatës Kombëtare Përfaqësuese.
- Agjencia Kombëtare e Rinisë shpalli thirrjen për projekt propozime ku përfituan financim 12 organizata dhe 4 bashki. AKR nuk bëri transparente buxhetimin e subjekteve përfituese, skemën dhe bordin e vlerësimit të organizatave dhe bashkive përfituese të granteve.
- Bordi i vlerësimit të granteve u krijua me urdhër të Ministrit të Arsimit, jo vetë nga AKR. Anëtarët e tij ishin zyrtarë të lartë të qeverisë, pa përfshirë përfaqësues nga shoqëria civile.
- Thirrja për Organizatën Kombëtare Përfaqësuese për Rininë qëndroi e hapur për 7 muaj dhe nuk pati asnjë aplikim. Kopetencat e këtij organi janë të paqarta për organizatat rinore.

- Në nivel lokal implementimi i ligjit po ecën me hapa më të ngadaltë se në nivel qendror. 28% e bashkive deklaruan se nuk e kanë filluar ende zbatimin e ligjit, ndërsa 46.5% e tyre nuk kanë filluar ngritjen e Këshillave Vendorë Rinorë.
- 74.4% e bashkive nuk kanë një buxhet të dedikuar për rininë, fakt që pamundëson realizimin e aktiviteteve që burojnë nga ligji për rininë. Edhe bashkitë që e kanë fondin, vlerat e tyre variojnë nga 100.000 deri në 500.000, shuma të pamjaftueshme në raport me nevojat e të rinjve.
- 69.7% e bashkive që i janë përgjigjur pyetësorit nuk e disponojnë një dokument strategjik për politikën rinore në nivel lokal, ndërkohë që vetëm 30.3% e tyre shpehen se në bashkitë e tyre ky dokument ekziston.
- 55.8% e bashkive nuk e disponojnë një database të aktorëve lokal apo organizatave lokale, ndërkohe që 44.2% shprehen se e disponojnë një të tillë.
- Të gjitha bashkitë e vendit kanë një qasje të hapur, pozitive dhe konstruktive kur bëhet fjalë për rininë dhe iniciativa që mundet të angazhojnë ata, sidomos në nisma që kanë të bëjnë me përfshirjen e tyre në vendimarrje, jetën social-kulturore të vendit si dhe zhvillimin dhe fuqizimin ekonomik të të rinjve


7. REKOMANDIME

- Agjencia Kombëtare e Rinisë duhet të bëjë transparencë të plotë të procesit të grantimit të organizatave dhe bashkive duke publikuar fondin total, skemën, kriteret dhe bordin vlerësues, numrin total të aplikantëve, shumën dhe natyrën e projektit për secilin përfitues.
- AKR duhet të lehtësojë procedurat e aplikimit për grante për organizatat rinore dhe për të rinjtë dhe të përzgjedhë një periudhë më të përshtatshme për shpalljen e thirrjes.
- AKR duhet të tërheqë vëmendjen e bashkive që ende nuk kanë filluar zbatimin e ligjit dhe atyre që janë në proces të ngadaltë, për të mos krijuar hendek mes zbatimit në nivel qendror dhe atij në nivel lokal.
- 61 bashkitë e vendit duhet të krijojnë menjëherë databaza me organizatat lokale dhe të fillojnë procesin e ngritjes së Këshillave Rinorë Vendorë.
- Bashkitë në procesin e krijimit të Këshillave Vendorë Rinorë duhet të marrin në konsideratë edhe grupimet joformale rinore tashmë të krijuara ose njohjen e Këshillave ekzistues në bashkitë e tyre.
- Këshillat Bashkiak gjatë miratimit të buxhetit për vitin 2022 duhet të parashikojnë buxhet të dedikuar për rininë, në masën që mundëson zbatimin e detyrimeve që parashikon ligji për rininë.

8.ANEKSE

Aneksi I: Kërkesa për Informacion drejtuar 61 Bashkive

KËRKESË PËR INFORMACION

Kërkues: Shoqata Kongresi Rinor Kombëtar	Adresa postare: Rr. "Milito Tutulani", Nd. 6, Hyrja 8/3&4 Tirana, Albania Adresa elektronike: info@krk.al dafinapeci@krk.al ëëë.krk.al	Data: 
---	---	--

Autoriteti Publik:

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

Kongresi Rinor Kombëtar me mbështetjen e Fondacionit Gjerman Konrad Adenauer ka nisur këtë vit implementimin e projektit " Drejtë një dialogu më efektiv/Seritë e Rezolutës së Rinisë" në kuadër të të cilit po zhvillon monitorimin e zbatimit të "Ligjit për Rininë" dhe akteve nën ligjore të tij duke përfshirë: strukturat në nivel vendor, strukturat në nivel qendror dhe Agjensinë Kombëtare të Rinisë. Metodologjia e këtij raporti përfshin: desk research, fokus grupe, gjenerimin e të dhënave parësore (Kërkesë për informacion dhe intervista) si dhe hulumtimin mbi të dhënat dytësore dhe analiza ekzistuese mbi çështjen. Kjo kërkesë për informacion ka si qëllim gjenerimin e të dhënave parësore duke u bazuar në LIGJIN Nr. 75/2019 PËR RININË, konkretisht tek Neni 7 "Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore"; Neni 8 " Institucioni Përgjegjës për Rinisë"; dhe Neni 10 "Këshilli Vendor i Rinisë".

Në përputhje me këtë ligj, kërkojmë të na vihen në dispozicion të dhënat e më poshme:

1-Neni 7, pika 1/b, i Ligjit për Rininë, parashikon krijimin e këshillave vendor të rinisë. Aktualisht në cilën fazë është procesi i themelimit të këtyre këshillave në bashkinë tuaj?

2-Neni 7, pika 1/c parashikon organizimin dhe koordinimin e veprimtarive që synojnë arritjen e objektivave vendore në fushën e mbrojtjes dhe të fuqizimit të të rinjve. Cili është dokumenti strategjik në lidhje me çështjet rinore në bashkinë tuaj dhe cili është plani i aktiviteteve që parashikoni për përmbushjen e ligjit në lidhje me këtë pikë?

3-Neni 7, pika 1/dh, parashikon financimin e krijimit dhe të zhvillimit të infrastrukturës rinore dhe të hapësirave rinore të sigurta. Aktualisht a ka ndonjë zë të dedikuar për këtë çështje në bashkinë tuaj? Nëse po ju lutem specifikoni.

4-Neni 7, pika 1/e, parashikon krijimin e strukturave administrative për çështjet e rinisë. A ka filluar ngritja e këtyre strukturave në bashkinë tuaj? Nëse po, ju lutem specifikoni.

5- Neni 7, pika 1/ë, përmend, parashikimin, në buxhetet e tyre, të fondeve për realizimin progresiv të të drejtave të të rinjve për zhvillimin e projekteve, programeve dhe veprimtarive rinore. A ka parashikuar bashkia juaj ndonjë zë të dedikuar në buxhetin e 2021 për këtë çështje? Nëse po, ju lutem specifikoni.

6-Neni 7, pika 1/f parashikon mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave, në bashkëpunim me institucionet e tjera, për situatën e të drejtave të të rinjve në territorin e tyre. A ka nisur bashkia juaj të zhvillojë takime apo konsultime në kuadër të kësaj pike? Në cilën fazë ndodhet aktualisht ky proces dhe cilët janë aktorët e përfshirë?

7- Neni 8, pika 1 parashikon ngritjen e Institucionit përgjegjës për rininë, që është person juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për rininë, që financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme dhe ushtron veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Në cilën fazë është zbatimi i kësaj pike në bashkinë tuaj?

Të tjera të dhëna

NIPT: L71729453B

Vendim Gjykatë nr. 5351/1

Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni: Në formë elektronike

Vetëm për përdorim zyrtar

Data e marrjes:
__/__/201__

Numri rendor i kërkesës:

Komente: _____

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

Aneks 2: Pyetësi Online drejtuar 61 Bashkive

Monitorimi i Investimit dhe Implementimit të "Ligjit për Rininë"

Kongresi Rinor Kombëtar me mbështetjen e Fondacionit Gjerman Konrad Adenauer ka nisur këtë vit implementimin e projektit "Drejtë një dialogu më efektiv/Seritë e Rezolutës së Rinisë" në kuadër të të cilit po zhvillon monitorimin e zbatimit të "Ligjit për Rininë" dhe akteve nën ligjore të tij duke përfshirë: strukturat në nivel vendor, strukturat në nivel qendror dhe Agjensinë Kombëtare të Rinisë. Metodologjia e këtij raporti përfshin: desk research, fokus grupe, gjenerimin e të dhënave parësore (Kërkesë për informacion dhe intervista) si dhe hulumtimin mbi të dhënat dytësore dhe analiza ekzistuese mbi çështjen. Ky pyetësor do të shërbejë për gjenerimin e të dhënave që do të bëhen pjesë e raportit përfundimtar. Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale". *Ky pyetësor është hartuar në bazë të ligjit Nr. 119/2014 "PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT".

1.Emër Mbiemër

2.Kontakt (email)

3.Kontakt (Cel)

4.Bashkia që përfaqëson:

5.A keni dëgjuar për "Ligjin për Rininë":

Po

Jo

6.A ka filluar implementimi i "Ligjit për Rininë" në bashkinë tuaj?

Po

Jo

7.A ka filluar ngritja e Këshillave Rinor Vendorë pranë bashkisë suaj?

Po


Jo

8.A ka bashkia juaj nje plan dhe buxhet për përmbushjen e direktivave që parashikon "Ligji për Rininë"?

Po

Jo

9.Nëse po, ju lutem specifikoni llojin e aktiviteteve dhe shumën totale të buxhetit:

An empty rectangular text input field with a light gray border and a white background, containing no text.

10.A ka bashkia juaj një strukturë apo person të dedikuar për rininë?

Po

Jo

11.A ka bashkia juaj një dokument strategjik apo plan veprimi për rininë?

Po


Jo

12.A ka institucioni juaj një databazë të organizatave rinore që operojnë në bashkinë tuaj?

Po

Jo

14.Si e vlerësoni rolin e organizatave të shoqërisë civile në bashkinë tuaj?

An empty rectangular text input field with a light gray border and a white background, containing no text.